

MARRËVESHJE

PËR KRIJIMIN E KOALICIONIT “SHTËPIA E LIRISË”

Sot më datë 31.01.2022, ne, partitë politike të mëposhtme:

*Ne po bashkohemi, si parti dhe si qytetarë, për t'i sjellë ndryshimin Shqipërisë.
Ne bashkohemi që të garantojmë fitoren në zgjedhjet e ardhshme dhe t'i sjellim ndryshim
vendit tonë.*

*Të gjithë e dimë që duhet ndryshim. Shqiptarët janë të fortë, Shqipëria është e
fortë. Ka vetëm një njeri përgjegjës për dështimin e Shqipërisë në 8 vitet e fundit dhe ky
është Edi Rama.*

*Ne po ndajmë të njëjtat vlera e parime në veprimtarinë e përgjithshme politike, si
edhe në vizionin për qeverisjen e vendit. Dëshirojmë të koordinojmë angazhimet dhe
kontributin për fitoren e përbashkët politike dhe prandaj*

VENDOSËM QË:

1. Të formojmë një Koalicion të gjerë opozitar, dhe për të konkuruar së bashku në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Rrogozhinë, Vorë dhe Lushnjë, të datës 06 Mars 2022.
2. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë”
3. Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: “SH-L”



Sigla e Koalicionit është:

Drejtuuese politike e koalicionit është **Partia Demokratike e Shqipërisë** e përfaqësuar nga **Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit**

Partia udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor është partia **Lëvizja Socialiste për Integrim**.

4. Të autorizojmë zj. Monika Kryemadhi, Kryetari i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, ose të autorizuarin prej saj, që të paraqesë pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) kandidatët për kryetar bashkie në këto njësi, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve deri në përfundim të procesit zgjedhor.

5. Të autorizojmë Z. Endrit Braimllari që:

- a. Të paraqesë kërkesë për regjistrimin e Koalicionit, së bashku me këtë marrëveshje, pranë KQZ-së.
- b. Të përfaqësojë Koalicionin gjatë procedurës së shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
- c. Të caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të, në të gjithë vendin.

6. Termat konkrete të bashkëpunimit brenda koalicionit do të përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të partive politike në përbërje të tij.

7. Në listën shumëemërore të Koalicionit zgjedhor do të përfshihen, për çdo parti të koalicionit, numri i kandidatëve dhe renditja e tyre, bazuar në peshën elektorale që rezulton për secilën parti. Kandidatët në listat shumëemërore të Koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen dhe vlerësohen si kandidatë vetëm të Koalicionit, duke shmangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake.

8. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë ditën e nënshkrimit të saj.

Partitë e Koalicionit, firmëtare të kësaj marrëveshje, janë:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit

Flamur NOKA



[shqiptarja.com]

**PARTIA LËVIZJA SOCIALISTE PËR
INTEGRIM**

Sekretari i Përgjithshëm

Endrit BRAIMLLARI



[shqipetaria.com]

PARTIA DEMOKRISTIANE

Kryetari

Nard NDOKA



[shqip.com]